

ABSTRAKT

Tema : Regjistrimi i të drejtave sendore, nevoja për regjistrim të pronave përmes një procesi të organizuar nga shteti.

Republika e Kosovës ka kaluar në etapa të ndryshme kohore të cilat, kanë ndikuar edhe në regjistrimin e të drejtave sendore kështu, duke sjellur probleme me të cilat ballafaqohemi edhe sot e kësaj dite. Andaj, ky punim ka për qëllim sqarimin e nevojës për një proces të organizuar nga shteti lidhur me shndërrimin e poseduesve faktik në pronarë juridik.

Ky hulumtim është realizuar me anë të metodave deskriptive historike, metodës analitike dhe metodës krahasuese me qëllim që të nxirret një pasqyrë e qartë lidhur me regjistrimin e të drejtave sendore në Republikën e Kosovës. Normat pozitive në vendin tonë, garantojnë rrugën ligjore për një proces të organizuar nga shteti. Nga analizimi i gjendjes në teren apo nga rastet praktike vërejmë qartazi problemet e pronarëve lidhur me vërtetimin e pronësisë përshkak të mungesës së regjistrimit në librat kadastral. Poashtu, theksojmë se, lufta e fundit në Kosovë dhe zhdukja e këtyre librave ka pasur një ndikim shumë negativ në vendin tonë.

Problemet e lartcekura mendoj se, do të gjenin një zgjidhje me anë të kontributit shtetëror në këtë drejtim, duke angazhuar komisionet kadastrale si dhe duke avancuar rrugët ligjore për realizimin e një procesi të tillë.

Fjalët kyçe: *Kadastru, sistemet kadastrale, të drejtat sendore, regjistrimi i të drejtave sendore, poseduesi faktik.*

Mentor: **Prof.Dr.Haxhi Gashi**

Kandidati: **Florian Tishuki**